



ME EMRIN E ALL-LLAHUT, MËSHIRUESIT, MËSHIRËBËRËSIT!

“Po ka nga njerëzit që blenë tregime boshe e më qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së Allahut pa pasur kurrfarë fakti dhe për t'i marrë ato (ajetet e Allahut) si tallje...”

(Lokman: 6).

“Kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se dëfrim e lojë, e jetë e vërtetë, pa dyshim është ajo e botës së ardhme (Ahireti), sikur ta dinin”.

(Er-Rum: 62)

Pas të ndejturit të lodhshëm, shpeshherë të mërzitshëm në bankat shkollore, mundimet nëpër ligjërimore të fakulteteve, në vende të punës, në shtëpi... të rinjtë ndjejnë nevojë për zbavitje...

Për këtë u shërbejnë kafenetë, restorantet, bufetë, kafehanet dhe në mbrëmje - diskotekat. Si vende për pushim, bisedë, takime, shaka dhe ndonjë punë të vogël, kafehanja ka traditë të gjatë.

Bota vërshon me nxitje të përtacisë dhe perdeve të tymosura në vend të bisedës, me muzikën kumbuese në vend të së vërtetës, me vrull kafenesh e diskotekash në vend të dritës së përcaktueshmërisë. Kurse prindërit janë të bindur se shkollat janë të vështira dhe se për to duhet shumë mund e djersë. Ata nuk i ngarkojnë me kurrfarë obligimesh djemtë dhe vajzat e tyre, prandaj ata rrallëherë punojnë në shtëpi, madje ata janë të liruar edhe nga mektebi-xhamia, mjafton ajo të bëhet prej Ramazanit në Ramazan ose aspak fare. Vetëm le të mësojmë dhe le të mendojmë vetë se si do t'i kalojnë pushimet apo ditët e lira.

Shumë prej tyre vendosin shpejtë, i pret shoqëria, hiti i ri, kurse të tjerët për hirë të miqve dhe për të mos

mbetur anash kur të ritregohen argëtimet, shkojnë në diskoteka. Prindërit as nuk e dinë ç'është diskoteka ose u besojnë në fjalë djemve dhe vajzave të tyre se asgjë të keqe nuk do të bëjnë. Të moshuarit, studentët, ose të punësuarit, kaheër shijuan këtë ëmbëlsirë, ata tani më kanë shoqëri të përhershme, skutën e tyre, kohën e kalojnë në kafene e diskoteka, sepse nëse jo tash, në vitet më të bukura, kur atëherë?!..

Po ç'farë është atmosfera në diskotekë?

Në këto hapësira çdo gjë është zë e lëvizje, le të kalojë koha, le të ndodhë diçka. Muzikën shurdhuese e ndal vetëm zëri i disk-xhokejit. Nëpër tymin e dendur shkëlqejnë drita të të gjitha ngjyrave e voltazheve. Brenda luhet, ndalet, vështrohet. S'është e domosdoshme njohja. Shprehjet e vallëzuesve me anë të muzikës tregojnë entuziazëm të vërtetë ose të rrejshëm. Të ngjitur njeri me tjetrin, djelmoshat e vajzat çlirohen nga energjia e tepërt, se afërsia trupore do të thotë afërsi e siguri e vërtetë. Iluzioni i jetës intenzive që fitohet në këto hapësira të rezervuara për zbavitje e ngjallin magnetët e huaj të bukurisë duke ofruar aroma të jashtme dhe tualete. Djelmoshat e vajzat të përqaftuar e të puthitur me njëri tjetrin, i lëshohen kënaqësisë së puthjeve, të lumtur dhe të pa penguar nga shikimet përbuzëse të moralistëve. Biseda është reduktuar në minimum.

Vallë! A nuk dëshirovan kaheër të rinjtë të lllomotisin?

Këtu, edhe po qe se ju shkon kjo për dore, temat janë të zbehta: - garderoba “copë” e re dhe e “zbathur”, pikniqet, hitet e vendeve të jashtme, sporti, pija, thashethemet etj. Ndërsa për librin e lexuar, shfaqjen e shikuar teatrore, filmin e shikuar dhe manifestimin kulturor, nuk ka kohë të bisedohet...

Çka u bë tash me këtë?

Gjuha është e veçantë, e çliruar nga kufizimet e normat, ajo është gjuhë zhargoni, eufemizmi, lokalizmi, e madje dhe gjuhë sharjeje. Të rinjtë tanë kalojnë orë të tëra me shpresë se do t'u ndodhë diçka, do ta takojnë dikë, duke e përjetuar këtë gjendje

çdoherë nga fillimi.

Janë më të fortë në errësirë, e harrojnë botën e më të rriturve. Janë të ngadhënjyer me zërat e idhujve të tyre. E ndoshta është e mundur edhe dashuria romantike, me të cilën do të ndeshen nëse bëhen më të mirët, më të pashmit, më interesantët... presim, shpresojmë ende s'është koha për t'ua thënë.

Ç'është ajo që të rinjtë i shpie në vende të tilla?

MUZIKA!

Është përgjigja më e shpeshtë e konsumatorëve të disko-shërbimeve, ose mbase siç tërheqin vërejtjen ca rezistenca ndaj çdo sendi që nuk e krijuan vetë: ndaj ambientit familjar, ndaj vlerave të moralit të rrejshëm dhe konventave që i ndeshim, rezistenca ndaj të gjitha vlerave që u ofrohen. Të ndalemi në përgjigjen se muzika është shkaku kryesor i shkuarjes në disko. Nëse është ashtu, vallë, a s'mundet të ndëgjohet edhe në shtëpi? Mundet ose s'mundet! Varet nga vendi, mirëpo edhe aty ku mundet, shkohet në disko.

Ç'farë është ajo muzikë dhe ç'konsiderohet këtu muzikë?

Të përkujtojmë se çdo muzikë dhe çdo art është shprehje e frymës së kohës në të cilën lindi. Muzika që dëgjohet në diskoteka e kafene e konfirmon këtë më së miri. Ajo muzikë dëgjuesin e sjell në një gjendje, në të cilën këndellen instiktet dhe emocionet, sikur të fryerit në calikë të madhe, kurse indisponimi, të shqetësuarit, ngrohtësia e çuditshme plot rrënoqthje, letargjia (por edhe dhuna) gjejnë vendin e vet nën lëkurë. Është e mundur të jetë ashtu, mirëpo çka thonë më të udhëzuarit: një ekspert i kësaj problematike thotë:

“Duke i patur parasysh të gjitha faktet që i përmendëm, mund të përfundojmë se, nëse muzika e grupeve vokalo-instrumentale në tërë intenzitetin e saj, me kualitet zërash tonik, me ritëm si edhe me efektin vizuel sulmues, dëgjohet në sallë që nuk është akustike, atëherë lind ndikimi i dëmshëm i asaj muzike, sepse veglat muzikore prej teli, frymë e goditjeje me ekcese të tepëruara vokale, bëjnë presion të fortë psikik, shqisor, fizik, dhe emotiv tek dëgjuesi...”

Pos kësaj, është me rëndësi ku mbahet ajo shfaqjeje e pop-rokut, në sallë akustike apo në vend të hapur. Ajo zharmë melodike muzikore, në sallë të vogël, me shumë instrumente është ferr i vërtetë vokalik e fërshëllues, i cili mund të ndikojë në të dëgjuarit, sistemin nervor dhe në sistemin hormonal. Zhurma muzikore, po që se zgjat një kohë të gjatë, dhe në mënyrë të qëndrueshme periodike, konsiderueshëm ndikon, para së gjithash, në vetë veshin e solistit dhe të dëgjuesit, e pastaj edhe në sistemin nervor, në sferën emotive afektive, e cila nuk mund të krijojë një njeri të shqetësuar dhe përjetësisht të vrullshëm, pa program pa qëndrim e seriozitet në jetë.

T'i pyesim tani sociologët, përse të rinjët shkojnë në vende të tilla?

"Njerëzit nuk janë të vetëdijshëm, ose nuk janë mjaft të vetëdijshëm, se jetën e tyre të përditshme e mbikqyrin grupe të fuqishme, të cilat përmes mosmendimeve vërshojnë me simbole të seleksionuara e të organizuara kujdesshëm, funksioni i të cilave nuk është ta informojë botën, por t'i shfrytëzojë nevojat e botës. E vetmja gjë që na ngushëllon për mjerimin tonë është argëtimi, mirëpo ai është mjerimi ynë më i madh, sepse kryesisht, ai është që na pengon të mendojmë për veten dhe që i pengon të mendojmë për veten dhe që pandjeshëm na shkatërron.

Po të mos ishte ai, do të vuanim dhe ajo vuajtje do të na shtyente të kërkojmë ndonjë mjet më të sigurt që të çlirohemi nga ai, mirëpo dëfrimi na argëton, dhe pandjeshëm na shpie në vdekje. Më lehtë është të përballohet vdekja kur nuk mendohet për te se sa vetë ideja për vdekjen kur na kërcënohet ajo. Me që njerëzit nuk ja arritën të shërohen nga vdekja, nga mjerimi, nga mosdija, që të jenë të lumtur, bënë çmos që të mos mendojnë për to. Edhe sfera e argëtimit u bë sferë e tjetërsimit, sepse harresa momentale e të gjitha pyetjeve të mallkuara të jetës dhe vdekjes nuk i hjek dhe nuk i zgjedh ato pyetje, të cilat qysh orën apo ditën e ardhshme, përsëri kthehen në vetëdijën e mjerë edhe

më shumë të rënduar nga brengat dhe dyshimet e zeza. Ndoshta ju tash do të thoni: Po me të vërtetë shkuarja në disko për djaloshin dhe vajzën serioze, për ata që mendojnë dhe kujdesen për vete, nuk është për muslimanin!

Mirëpo! Ç'mund të ofroni si kompenzim për këtë?

Pyetja është normale, mirëpo tregon mosnjohje apo mosnjohje të mjaftueshme të Islamit. Islami nuk erdhi që robërimin ndaj materies ta zëvendësojë me robërimin ndaj shpirtit, që robërimin ndaj idhujve ta zëvendësojë me robërim ndaj njeriut, që disa epshe t'i zëvendësojë me të tjera. Ai erdhi që ta kthejë njeriun te Krijuesi i vet, duke e kthyer ka vlerat e vërteta!

Allahu nuk e lë njeriun të vetëm, nuk e lë shumë të bredhë vetëm nëpër humnerë të botës dhe të arsyes. Ai i ofron dritë që t'i ndriçojë rrugën:

"... Ai ju jep dyfish nga mëshira e tij, ju dhuron dritë që ecni me të..."

(Hadid: 28)

Islami është realitet jetësor...

Përshtati:

Valeriana Ajdini

Kaqanik, 2005

KLUBI STUDENTOR

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com

